



Datë: 22.03.2019

Duke u bazuar në Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Administrata Tatimore e Kosovës shpall:

KONKURS I JASHTËM

Titulli i pozitës: Inspektor Tatimor (20 pozita)

Nr. i referencës së pozitës së punës: INS/230/JP00038303

Përgjegjësi mbikqyrëse: Jo

Pozita: Nëpunës i karrierës – periudha provuese; Dymbëdhjetë (12) muaj

Orari i plotë i punës: Po

Koeficienti: Shtatë(7) plus shtesa e aplikuesahme

Vendi i punës: Operacionet-Drejtoria e Përgjithshme

Qëllimi i vendit të punës:

Qëllimi i pozitës është bashkëveprimi në mënyrë të duhur dhe profesionale me të tjerët dhe menaxhmentin për t'u kujdesur dhe mbajtur marrëdhënie të një niveli të duhur pune. Në të njëjtën kohë duke aplikuar njohuritë dhe aftësitë teknike në detyrën e përcaktimit të saktë të obligimit tatimor të tatimpaguesit. Identifikimi dhe zgjidhja e saktë e çështjeve dhe interpretimi i saktë i ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe burimeve tjera të informatave janë kompetentët kyçe në këtë vend pune.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Edukimi dhe ndihma ndaj tatimpagueseve në zyrat e Administratës Tatimore apo në zyrat e biznesit;
- Vizita përmbushëse të tatimpaguesi ;
- Te ekzaminojë librat ,llogaritë dhe regjistrimet e mbajtura të tatimpagueseve në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor në mënyrë të saktë, të plotë dhe në kohë në lidhje me obligimet e tyre tatimore;
- Shqyrtimi i llogarive të biznesit dhe varësisht nga gjendja bëjnë vlerësime kur është e nevojshme ;
- Është përgjegjës për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve tatimore që aplikohen në Kosovë e që administrohen nga Administrata Tatimore;
- Kryen aktivitete për zbatimin e ligjit për Sigurime Shendetësore dhe Pensione ;
- Te asistojë tatimpaguesit në dhënien e informatave dhe shërbimeve në afate të caktuara kohore dhe me metoda me të përshtatshme për tatimpaguesit;
- Dhënia e këshillave zyrtare mbi çështjet tatimore për tatimpaguesit;
- Zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve për sigurime shëndetësore dhe pensione;
- Përfaqësimi i Administratës Tatimore para një tribunali të pavarur për çështje kontestuese;
- Kryen edhe punë tjera që i ngarkohen e që ndërlidhen me fushë veprimtarin e inspektorit tatimor;.

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

Që të kryej këtë punë me sukses, një individ duhet të ketë:

- Diplomë universiteti ne Fakultetin Ekonomik, Juridik apo te Biznesit;
- Së paku 3(tri) vite përvojë pune profesionale;
- Aftësi për punë ekipore, organizative dhe gadishmëri të punoi nën presion;
- Njohuri per legjislacionin qe zbatohet dhe administrohet nga Administrata Tatimore;
- Aftësi të mira profesionale dhe vullnet për të kontribuar në mënyrë konstruktive;
- Të posedojë aftësi të mira komunikimi dhe në shkruarjen e raporteve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve ;
- Të mos ketë dosje penale (të vërtetuar me certifikatë nga gjykata kompetente);

Paraqitja e kërkesave:

Administrata Tatimore e Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), letërnjoftimin, Dëshminë e përvojës së punës dhe dy referenca.

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Clinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: www.atk-ks.org tek rubrika e punësimit.

Dokumentacionet duhet të dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, Ndërtesa e ATK-së Drejtoria e Përgjithshme, kati i V-të, zyra nr. 506. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1 vjeçare.

Afati i konkurrimit është prej datës 22/03/ 2019 deri me datë 05/04/ 2019, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrin: 038/20034706.